



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 9853 Prot.

Tiranë, më 06.07 2017

Lënda: Njoftim

Drejtuar: Të gjithë Autoriteteve Kontraktore

Agjencia e Prokurimit Publik njofton njësitë e qeverisjes qendrore dhe autoritetet kontraktore në varësi të tyre se për prokurimin e fondeve në dispozicion të tyre, duhet të referohen dhe të zbatojnë parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.482, datë 05.07.2017 “Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurimit për vitin 2017”.

Për këtë qëllim, nga ana e autoriteteve kontraktore subjekt të vendimit të sipërcituar, duhet të merren të gjitha masat paraprake për mos nisjen e procedurave të reja të prokurimit, si dhe për pezullimin e përkohshëm të të gjitha procedurave të prokurimit të filluara.

Për procedurat e prokurimit të cilat janë publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe janë në fazën e pritjes së ofertave, pra janë para datës së përcaktuar si “**Afati i fundit për pranimin e ofertave**”, duhet të bëhet menjëherë pezullimi i tyre teknikisht, nga roli i Administratorit të Sistemit të autoritetit kontraktor.

Këto procedura prokurimi do qëndrojnë të pezulluara në sistem, deri në daljen e një vendimi/njoftimi tjetër për këtë qëllim.

Lidhur me procedurat e prokurimit të cilat janë në proces vlerësimi duhet të bëhet menjëherë pezullimi i vlerësimit të tyre, sipas parashikimeve të Udhëzimit të APP Nr. 05, datë 05.07.2017 “Për veprimet e Administratorit të Sistemit të Autoritetit Kontraktor në Sistemin e Prokurimit Elektronik” (pezullimi në këtë rast bëhet në formë shkresore) dhe më pas, nga ana e autoritetit kontraktor nuk duhet të kryhet asnjë veprim tjetër, deri në daljen e një vendimi/njoftimi tjetër.

Në lidhje me vendimin e pezullimit duhet të njoftohen të gjithë ofertuesit pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Ky njoftim duhet t’i dërgohet atyre nga llogaria e njërit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, me anë të butonit “Kërkesë e re” .

Përfundohen nga zbatimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 482, datë 05.07.2017 “Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurimit për vitin 2017”, kontratat e nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe prokurimet me vlerë të vogël.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Elona Hoxhaj

